



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/14  
Datë: 28.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen procesverbalet dhe transkriptet e mbledhjeve; 8-të dhe 9-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/14

Datë: 28.05.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 08 -P- 16 të datës 17.05.2021, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete, si në vijim:
  - 1.1. Nisma legjislative nga pika 1. e këtij Vendimi është përcaktuar që Projektligji duhet analizuar hollësisht në mënyrë që të adresohen rekomandimet e dhëna, si dhe të harmonizohet me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës si dhe qëllimi i të cilit është të ndryshohet një nen, në mënyrë që të hiqet detyrimi për homologim për mjetet rrugore të reja që kanë certifikatë konformitetit;
  - 1.2. Mendimi i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës: “[...] Ministra e përkrah propozimin të deputetëve të Republikës së Kosovës dhe konsideron se ka për qëllim realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik”;
  - 1.3. Duke pasur parasysh Opinionin e Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve “[...] Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete nga aspekti i ndikimit buxhetor nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, duke nënkuptuar se të gjitha aktivitetet të cilat dalin nga ky projektligj do të zbatohen nga ndarjet buxhetore të parapara për Departamentin e Automjeteve që funksionin në kuadër të MMPHI për vitet 2021-2023”;
  - 1.4. Opinionin e Përputhshmërisë me Acquis të BE-së: Dispozitat e “Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-132 për Automjete” nuk janë të rregulluara në mënyre strictu sensu me legjislacion të BE-së.
2. Ky Vendim së bashku me mendimet e ministrive përkatëse i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/14  
Datë: 28.05.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Grupi Punues ndërinstitucional për rishikimin e Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Kosovës 2021-2030, në këtë përbërje:
  - 1.1. Këshilltari për Siguri i Kryeministrit të Republikës së Kosovës - kryesues;
  - 1.2. Përfaqësues i Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës - zv. kryesues;
  - 1.3. Përfaqësues i Zyrës për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit - anëtar;
  - 1.4. Përfaqësues i Zyrës Ligjore në Zyrën e Kryeministrit - anëtar;
  - 1.5. Përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit për Integritet Evropian - anëtar;
  - 1.6. Përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - anëtar;
  - 1.7. Përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes - anëtar;
  - 1.8. Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë - anëtar;
  - 1.9. Përfaqësues nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - anëtar;
  - 1.10. Përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë - anëtar;
  - 1.11. Përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme - anëtar;
  - 1.12. Përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë - anëtar;
  - 1.13. Përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - anëtar;
  - 1.14. Përfaqësues nga Ministria për Komunitete dhe Kthim - anëtar;
  - 1.15. Përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - anëtar;
  - 1.16. Përfaqësues nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë - anëtar;
  - 1.17. Përfaqësues nga FSK-së - anëtar;
  - 1.18. Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës - anëtar;
  - 1.19. Përfaqësues i Drejtorisë Përgjithshme të Doganës së Kosovës - anëtar;
  - 1.20. Përfaqësues i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent - anëtar.
2. Në këtë Grup punues ftohen edhe përfaqësues nga Presidenca e Republikës së Kosovës si dhe nga Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes.
3. Në cilësinë e vëzhgueseve dhe ekspertëve mund të ftohen Organizatat Jo-Qeveritare, Organizatat Ndërkombëtare dhe Ambasadat e huaja që veprojnë në Kosovë, si dhe ekspertë të tjerë vendor dhe ndërkombëtarë.

4. Sipas nevojave të punës dhe për realizimin e obligimeve të parapara me këtë vendim Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë ekspertë dhe përfaqësues të tjerë.
5. Përgjegjës për mbështetjen administrative dhe koordinimin e procesit të hartimit të Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Kosovës është Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës.
6. Obligohet Grupi punues që të rishikojë Strategjinë nga pika 1. e këtij Vendimi, në pajtim me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit.
7. Afati e rishikimit të Strategjisë së Sigurisë së Republikës së Kosovës është dy (2) javë nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/14  
Datë: 28.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, nenit 93 paragrafi 4 dhe nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 2.4, nenit 10 dhe nenit 12 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në zbatim Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020, për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, dhe në zbatim të rekomandimeve të IKShPK-së me qëllim të kontrollit, parandalimit dhe luftimit të përhapjes së virusit SARS-CoV-2, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19**

**A. [Zbatimi territorial]**

1. Ky vendim zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

**B. [Hyrjet dhe daljet e qytetarëve të huaj nga Republika e Kosovës]**

2. Qytetari i huaj që hyn në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ata me leje qëndrim të përkohshëm ose përhershëm në Kosovë, që vijnë nga vendet me risk të lartë sipas listës zyrtare të ECDC-së, duhet të kenë test RT-PCR negativ për COVID-19 të bërë në 72 orët e fundit, në bazë të parimit të reciprocitetit.
3. Përfjashtim nga pika 2 bëjnë:
  - 3.1. Nëse qytetari i huaj hyn në Kosovë përmes aeroportit apo përmes pikave kufitare tokësore dhe largohet nga Kosova brenda 3 ore përmes aeroportit ose pikave kufitare tokësore, me kusht që në hyrje të nënshkruaj deklaratën se do ta lëshojë Kosovën brenda tre (3) ore;
  - 3.2. Qytetari i huaj që punon si transportues profesionist (vozitës), me kusht që të respektojë protokollin për transport ndërkombëtarë për mbrojtje nga Covid-19;
  - 3.3. Qytetari i huaj që kalon nëpër Kosovë përmes transportit të organizuar me autobus ose me linjë të rregullt ndërkombëtare, transit, me kusht që të nënshkruhet deklarata se do ta lëshojë territorin e Kosovës brenda pesë (5) orësh;
  - 3.4. Diplomatatë e huaj të akredituar në Kosovë si dhe familjarët e tyre;
  - 3.5. Personi që ka dëshmi për marrjen e vaksinës kundër COVID-19;
  - 3.6. Personi me një rezultat pozitiv të testit të antitrapave serologjik -IgG lëshuar më së shumti tridhjetë (30) ditë para mbërritjes.

4. Ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës për personat që vijnë nga India, Brazili dhe Afrika e Jugut.
- 4.1. Shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët vijnë nga India, Brazili dhe Afrika e Jugut duhet të karantinohen në shtëpitë (vendin e banimit) e tyre për katërmbëdhjetë (14) ditë duke u testuar dy herë në javë;
- 4.2. Pika 4.1 nuk vlen për shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët qëndrojnë transit (më pak se 48 orë) në shtetet e përcaktuara në pikën 4.1 të këtij vendimi.
- 4.3. Diplomatët e huaj përjashtohen nga fushëveprimi i pikës 4 të këtij vendimi.

#### **C. [Mbrojtja dhe siguria në punë]**

5. Gratë shtatzëna lirohen nga obligimi për t'u paraqitur fizikisht në punë. Punëdhënësit publikë apo privat udhëzohen të ju krijojnë mundësinë që të punojnë nga shtëpia.

#### **Ç. [Masat e përgjithshme të mbrojtjes dhe higjienës]**

6. Obligohen institucionet publike e private dhe në subjektet e tjera të mbajnë dezinfektues për duar dhe maska për fytyrë në vende të qasshme në hyrje të objektit dhe në ambientet e brendshme.
7. Obligohen institucionet publike e private dhe në subjektet e tjera që në hyrje të çdo objekti të vendosin shenja të dukshme të rregullave të sjelljes për mbrojtje nga Covid-19 (përfshirë shenjën e ndalimit të hyrjes në objekt pa maska, respektimin e distancës).
8. Obligohen përgjegjësit e institucioneve publike e private dhe në subjektet e tjera që të kryejnë dezinfektimin dhe ajrosjet e hapësirave të mbyllura.
9. Bartja e maskës duke mbuluar hundën dhe gojën është obligative, në të gjitha rastet përveç:
  - 9.1. Gjatë ecjes vetëm në ambient të jashtëm;
  - 9.2. Gjatë ngasjes së automjetit vetëm apo në grup me jo më shumë se katër (4) persona;
  - 9.3. Gjatë vrapit, çiklimit dhe ushtrimeve fizike;
  - 9.4. Gjatë ngrënies apo pijes.

#### **D. [Institucionet e arsimit]**

10. Institucionet publike dhe private të të gjitha niveleve të arsimit vazhdojnë mësimin sipas udhëzuesit përkatës për sektorin e arsimit.
11. Konviktet lejohet të punojnë sipas rregullit një student në një dhomë.
12. Të gjitha institucionet publike dhe private të të gjitha niveleve të arsimit, iu ndalohet organizimi i aktiviteteve jashtë mësimore, siç janë ekskurzionet, shëtitjet grupore, ahengjet e ndryshme të stafit mësimor apo të nxënësve – studentëve.

#### **Dh. [Paraqitja për skemat sociale dhe pensionale]**

13. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve udhëzohet të lirojë të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që menaxhohen nga MFPT-ja nga paraqitja e rregullt në zyrat përkatëse për qëllime të evidentimit siç kërkohet me ligjet përkatëse.

*E. [Kufizimi i mbledhjeve publike dhe private]*

14. Lejohen grumbullimet në ambiente të brendshme deri në pesëdhjetë (50) persona (mbledhjet, seminarët, trajnimet) me kusht që të mbahet distanca fizike mbi 1.5 metër në mes të personave.

14.1. Mbledhjet e Kuvendit dhe të Qeverisë lejohen pavarësisht numrit të personave.

15. Lejohen grumbullimet në ambiente të hapura deri në njëqind (100) persona me kusht që të mbahet distanca fizike mbi 1.5 metër në mes të personave.

15.1. Grumbullimet në ambiente të jashtme me interes të veçantë publik me mbi njëqind (100) persona kërkojnë miratimin nga Ministria e Shëndetësisë/Qendra Operative Emergjente, me rekomandim të IKShPK-së.

16. Organizimi i ahengjeve ndalohet deri me datë 15 qershor 2021, pas së cilës datë sipas situatës epidemiologjike do të ketë rivlerësim të kësaj pike.

17. Mbajtja e pritjes për ngushëllim/kryeshëndoshë lejohet duke siguruar që pjesëmarrësit të mbajnë maskat dhe 1.5 metër distancë nga njëri-tjetri si dhe duke respektuar me përpikëri udhëzuesin përkatës.

*Ë. [Kufizimet e kontaktit]*

18. Nga ora 00:00 deri në orën 05:00, ndalohet grumbullimi i më shumë se dhjetë (10) personave.

*F. [Qendrat tregtare dhe operatorët e tjerë ekonomikë]*

19. Lejohet veprimtaria e qendrave tregtare sipas udhëzuesit përkatës.

20. Obligohen të gjithë operatorët të cilët për veprimtari ekonomike kanë tregtinë me shumicë dhe pakicë që të përcaktojnë numrin maksimal të klientëve në lokal në të njëjtën kohë sipas rregullit - 1 person për 8 m<sup>2</sup>. Këta operatorë obligohen të shënojnë në hyrje numrin maksimal të klientëve të lejuar në të njëjtën kohë. Sipërfaqja llogaritet për zonën ku lejohen të qëndrojnë klientët.

*G. [Puna me palë]*

21. Personi përgjegjës i institucionit publik apo privat dhe i operatoreve ekonomik, obligohet që të ndalojë rreshtimin apo tubimin brenda dhe jashtë ambientit të punës/biznesit, përveç nëse ata mbajnë distancë fizike prej të paktën 1.5 metra nga grupet e tjera të personave.

*Gj. [Gastronomia]*

22. Shërbimet e gastronomisë lejohen të zhvillojnë aktivitetin e tyre në përputhje me udhëzuesin përkatës. Lejohen deri në pesëdhjetë (50) klientë për 100m<sup>2</sup> (5 persona për 10 m<sup>2</sup>). Sipërfaqja llogaritet për zonën ku shërbehet ushqimi dhe pijet.

23. Shërbimet e gastronomisë lejohet të zhvillojnë aktivitetin e tyre nga ora 05:00 deri në ora 23:00.

24. Muzika lejohet deri në ora 22:45.

25. Përgjegjësit e lokaleve duhet të sigurohen që klientët të mbajnë një (1) metër distancë nga klientët në tavolina të ndryshme.



26. Pjesa e prapme e një karrige, me pjesën e prapme të karriges tjetër duhet të jetë një (1) metër distancë.
27. Në hapësirat e brendshme lejohen deri në 4 persona në tavolinë. Në rast se tavolinat janë me të mëdha se dy (2) metra, atëherë parakusht është që të shfrytëzohet hapësira duke pasur parasysh kapacitetin prej pesë (5) persona në 10 m<sup>2</sup>.
28. Në hapësirat e brendshme lejohet shërbimi i ushqimit dhe pijeve vetëm për mysafiret që janë të ulur ose duke qëndruar në këmbë në një tavolinë ose në banak.
29. Në hapësirat e jashtme lejohen deri në gjashtë (6) persona në tavolinë, banak apo në tavolina në këmbë.
30. Çdo tavolinë duhet të jetë e pajisur me dezinfektues që përmbajnë së paku 60-70% alkool.
31. Duhet të vendosen udhëzuesit në hapësirat e jashtme të lokaleve lidhur me informimin e klientëve për protokollin e masave kundër COVID-19, i cili publikohet në uebfaqen e Ministrisë së Shëndetësisë.

#### **H. [Tregjet dhe therja e kafshëve]**

32. Lejohet veprimtaria e tregjeve publike të automjeteve, kafshëve dhe shpezëve deri në 40 % të kapacitetit.
33. Therja e kafshëve lejohet vetëm në ambientet e autorizuara për këtë qëllim.

#### **I. [Transporti publik]**

34. Transporti publik lejohet të punojë duke shfrytëzuar deri 50% të kapacitetit dhe sipas udhëzuesit përkatës.
35. Në taksi lejohen të udhëtojnë deri në tre (3) udhëtarë.

#### **J. [Teatrot, bibliotekat, etj.]**

36. Teatrot, bibliotekat, filarmonitë, galeritë, ansamblet, baleti, kinematë, qendrat rinore, muzetë, qendrat e kulturës me grupe apo Institucionet tjera të ngjashme vartëse të MKRS-së apo Komunave, lejohet të punojnë duke shfrytëzuar 50% të hapësirës/sipërfaqeve të objekteve përkatëse për të gjitha aktivitetet (si në shfaqje ashtu edhe në ushtrime).
37. Përgjegjësit për organizimin e aktiviteteve kulturore duhet të sigurohen që mysafirët të mbajnë maskat dhe 1.5 metër distancë nga njëri-tjetri.

#### **K. [Sporti dhe rekreacioni]**

38. Lejohen aktivitetet stërvitore të cilat duhet të realizohen në përputhje me protokollin vendore dhe ndërkombëtare sportive.
39. Lejohet organizimi i garave sportive pa prezencë të publikut përkitazi me protokollin dhe rekomandimet e organizatave botërore për organizimin e ngjarjeve sportive dhe me masat mbrojtëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
40. Numri i pjesëmarrësve në garë (sportistë, klube, zyrtarë, dhe pjesëmarrës tjerë të nevojshëm për zhvillimin e garës) përcaktohet nga federatat sportive duke respektuar masën e distancës dhe masat tjera mbrojtëse.

41. Lejohen aktivitetet garuese pa prezencë të publikut, të cilat duhet të realizohen në përputhje me protokollet vendore dhe ndërkombëtare sportive.
42. Lejohet shfrytëzimi i fitneseve, palestrave dhe të ngjashme për aktivitete individuale rekreative sipas udhëzuesit përkatës.
43. Shfrytëzimi i fitneseve, palestrave dhe të ngjashme bëhet në proporcion 1 klient në 8m<sup>2</sup>
44. Aty ku është e mundur në software të fitnesit/palestrës të përcaktohet numri maksimal i klientëve që mund të kenë qasje në hapësirat e fitnesit.
45. Obligohet që personi përgjegjës i fitnesit/palestrës të ketë kujdes të veçantë në pikun e vizitës së klientëve, e që llogaritet koha nga ora 17:00 – 20:00, që të respektohet distanca e përcaktuar në udhëzues.
46. Obligohet vendosja e shenjave informuese dhe dezinfektuesve (apo mjeteve të tjera për pastrimit) në secilën pajisje të fitnesit me qëllimit të vetëdijësimit dhe dezinfektimit të tyre nga secili klient pas përdorimit.

#### L. [Udhëzuesit dhe sqarimet]

47. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që të nxjerrë udhëzuesit e përkohshëm, të përgjithshëm dhe të veçantë për parandalimin dhe luftimin e COVID-19, si në vijim:
  - 47.1 Udhëzues i Përkohshëm për aplikimin e masave të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e Covid-19;
  - 47.2 Udhëzues i Përkohshëm për sektorin e shërbimeve personale dhe bizneseve, industrisë, administratës publike dhe OJQ-ve;
  - 47.3 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet arsimore të të gjitha niveleve;
  - 47.4 Udhëzues i Përkohshëm për gastronomi, hoteleri, sektorin e shitjes dhe qendra tregtare;
  - 47.5 Udhëzues i Përkohshëm për tubimet fetare, varrime, punëtori dhe aktivitete kulturore;
  - 47.6 Udhëzues i Përkohshëm për fitnese, palestra dhe aktivitete tjera rekreative dhe sportive;
  - 47.7 Udhëzues i Përkohshëm për transportin publik;
  - 47.8 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet e kujdesit shëndetësor;
  - 47.9 Udhëzues i Përkohshëm për aviacionin civil;
  - 47.10 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet korrektuese, qendra të azilit dhe të mbajtjes për të huaj.
48. Udhëzuesit nga pika 47 janë të detyrueshëm për të gjithë personat dhe sektorët ndaj të cilëve zbatohen.
49. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që në rast nevojë të nxjerr sqarime për pikat e këtij vendimi.

#### Ll. [Zbatimi]

50. Obligohet Ministri i Shëndetësisë, AUV dhe Policia e Kosovës, që në bashkëpunim me shtabet emergjente komunave, të mbikëqyrë zbatimin e këtij vendimi dhe të dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrit raport javor (çdo të premte deri në orën 16:00).

51. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, ShSKUK dhe IKShPK të dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrit raportin javor (çdo të premte deri në orën 16:00) për zbatimin e masave, gjendjen në institucionet shëndetësore, gjendjen epidemiologjike si dhe parashikimet për dy javët në vijim.
52. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që, bazuar në Ligjin Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19, në territorin e Republikës së Kosovës të nxjerrë vendime operationale varësisht prej situatës epidemiologjike dhe rekomandimeve të IKShP-së.
53. Obligohet Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse të mbikëqyrin zbatimin e masave, vendimeve të tjera dhe udhëzuesve përkatës në zbatim të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës.
54. Për shkelësit e masave, organet kompetente obligohen të shqiptojnë masat ndëshkimore sipas Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës dhe ligjeve të tjera në fuqi.
55. I vetmi autoritet që mund të interpretojë këtë vendim është Ministria e Shëndetësisë, ndërkaq çdo institucion tjetër mund të ofrojë sqarime për kategoritë respektive për të cilat aplikohet ky vendim, vetëm pas miratimit të atij sqarimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

*M. [Shfuqizimi i vendimeve 01/07 dhe 02/11]*

56. Shfuqizohen Vendimet e Qeverisë: Vendimi Nr. 01/07 i datës 18.04.2021 dhe Vendimi Nr. 02/11 i datës 07.05.2021.

*N. [Hyrja në fuqi]*

57. Vendimi publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyn në fuqi me datë 31.05.2021.

### **A r s y e t i m**

Sipas raportit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, situata epidemiologjike me COVID-19, në Kosovë paraqitet e qëndrueshme me vazhdimin e uljes së numrit të rasteve pozitive. Ulja e rasteve pozitive për dy javët e fundit krahasuar me dy javët paraprake shënon rënie për 67.08%.

Në një situatë të tillë, duke ju referuar të dhënave aktuale mbi situatën epidemiologjike dhe rekomandimeve të IKShPK - së, Qeveria cakton masa më të lehtësuara që mundësojnë një aktivitet të shtuar ekonomik por njëkohësisht synojnë kontrollin e përhapjes së infeksionit.

Ministria e Shëndetësisë ka bashkërenduar vendimmarrjen me palët e interesit, të cilat kanë qenë të ndikuara drejtpërdrejt apo tërthorazi nga pandemia. Qeveria vëren se këto palë kanë ushtruar të drejtën e tyre për ndikim demokratik në vendimmarrje, në përputhje me nenin 45.3 të Kushtetutës.

Lehtësimi i masave është bërë duke u kushtuar rëndësi tri objektivave:


- Parandalimi i përhapjes së infeksionit me COVID-19;
- Mos cenimi i aktiviteteve ekonomike, por duke pasur prioritet ruajtjen e jetës dhe shëndetit të popullatës;
- Ruajtja e shëndetit mendor dhe fizik të qytetarëve.

Masat e përcaktuara në këtë vendim si dhe afatet kohore shërbejnë që situata epidemiologjike të mbahet nën kontroll edhe përkundër të dhënave optimiste epidemiologjike në raport me infeksionin me COVID-19.

Heqja e pjesërishme e kufizimeve po bëhet me përgjegjësi dhe me përgatitjet e nevojshme për përballjen me një situatë eventuale të rritjes së numrit të infeksioneve, andaj, ndryshimi i situatës epidemiologjike rrjedhimisht kërkon vendime dhe masa të reja konform situatës së re.

Prandaj, në bazë të rekomandimeve të dhëna nga IKShPK-së, ministrinë e linjës, palët e interesit dhe ekspertët përkatës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Komunave
- Inspektorateve përgjegjëse
- Policisë së Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/14

Datë: 28.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet pika 1.4. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/08, e datës 21.04.2021, ashtu që z. Bajram Miftari emërohet zëvendës anëtar për lëndën E Drejta Kushtetuese, Organizimi i Sistemit Gjyqësor të Kosovës, Bazat e Sistemit të Bashkimit Evropian dhe të Drejtat e Njeriut, në vend të z. Hajrip Krasniqi.
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/08 e datës 21.04.2021.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin dhe biografinë e zëvendës anëtarit të lartcekur t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/14

Datë: 28.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, dhe nenit 15 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Autorizohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve të aprovojë transfere nga nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" në ndonjë nën-program tjetër në Tabelat 3.1 dhe 4.1 për shumatat individuale të kërkuara deri në vlerë prej dyzet mijë euro ( 40,000.00 €).
2. Shuma e përgjithshme e autorizimit sipas pikës 1. të këtij vendimi nuk mund të kalojë 20% (njëzetë për qind) të shumës së ndarë vjetore të nën programit "Shpenzimet e Paparashikuara".
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/14

Datë: 28.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni i Ministrave për Ndërmarrjet Publike, në këtë përbërje:
  - 1.1. Ministria e Ekonomisë – kryesuese e komisionit;
  - 1.2. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve- anëtar;
  - 1.3. Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës- anëtar;
  - 1.4. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - anëtare;
  - 1.5. Ministri i Zhvillimit Rajonal - anëtar.
2. Komisioni sipas pikës 1. të këtij vendimi do të paraqes në Qeverinë e Republikës së Kosovës propozime dhe do të përgatit debate lidhur me çështjet mbi Ndërmarrjet Publike.
3. Ky vendim shfuqizon vendimin e Qeverisë Nr. 05/09 të datës 01.07.2020.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/14

Datë: 28.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-070 për Mbeturina, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia (2021-2030) dhe Plan i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë.
2. Për zbatimin e kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimit, obligohen: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, komunat dhe institucionet tjera të përcaktuara në këtë Strategji dhe Plan të Veprimit.
3. Me këtë dokument strategjik synohet të arrihet zhvillimi i integruar dhe i qëndrueshëm i menaxhimit të mbeturinave i cili ndikon në ruajtjen e shëndetit publik, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.
4. Ky dokument synon t'i trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar katër (4) objektivat strategjike të cilat janë paraparë me këtë Strategji. Realizimi i këtyre objektivave strategjike do të luajë rol në shtyrjen e Kosovës përpara drejt zhvillimit të ekonomisë qarkore.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/14  
Datë: 28.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti mbi Nivelin e Ekzekutimit të Projekteve të Huamarjes Ndërkombëtare.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë